



Tetor– Dhjetor 2012

PËRMBAJTJA:

Përkushtimi ndaj Tatimpaguesve

- Qendra e Thirrjeve 1 vit punë
- Seminare me tatimpagues në të gjitha regjionet e ATK-së, lidhur me Deklarimin Elektronik
- Rezultatet e E-Deklarimit
- Procesi i fiskalizimit


Të hyrat Tetor-Dhjetor 2012

- ATK inkason të hyra sipas planifikimit



Të tjera:

- Takimi me palët e interesit
- Raportet ndërkombëtare

Të hyrat e realizuara 2009-2012



LINJA E BASHKËPUNIMIT PA PAGESË

NGA:  dhe 



0800-80-800

Tetor– Dhjetor 2012 BULETINI

Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të planit të punës dhe përmbledhjes së aktiviteteve, të cilat janë realizuar në periudhën *Tetor-Dhjetor 2012*.

Misioni :

- Të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore,
- Të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve, në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve, si dhe
- Të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjlojshëm, si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e qeverisë në një mënyrë efikase dhe me kosto të ulët.

Mbledhja e të hyrave nga ATK, dhe përkushtimi i saj për ngritjen e përbushjes vullnetare

Viti 2012 ka shënuar edhe një vit të suksesshëm, sa i përket arkëtimit të të hyrave për Administratën Tatimore të Kosovës.

ATK-ja ka arritur të realizoj të hyra më të larta për 9% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku janë grumbulluar 396.9 mil.€ prej tyre në emër të tatimeve 283.9 mil.€ dhe në emër të kontributeve pensionale 113.0 mil.€

Viti që e lamë pas ka qenë edhe më tej vit i sukseseve dhe ngritjes së kapaciteteve për të përmirësuar shërbimet ndaj tatimpaguesve.

Të arriturat më kryesore gjatë vitit 2012, përveç realizimit të të hyrave më të larta në krahasim me vitin e kaluar, duhet veçuar edhe vazhdimin e realizimit dhe funksionalizimit të mëtejshëm të disa projekteve më kryesore:


Hapja e Qendrës për Shërbim të Tatimpaguesve në regjionin e Prishtinës;

Zhvillimi dhe implementimi i projektit të pagesës dhe deklarimit elektronik - EDI;

Zhvillimi i mëtejshëm dhe zgjerimi i implementimit të projektit të arkave fiskale;

Funksionalizimi i sistemit të integruar të regjistrimit të bizneseve – One Stop Shop dhe pajisja me numër fiskal brenda ditës;

Funksionalizimi i Njesisë së Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës.



ATK-ja mbajti seminarin një ditor me tatimpaguesit e Lojërave të Fatit

Administrata Tatimore e Kosovës, ka mbajtur seminar me tatimpaguesit e Lojërave të Fatit, me Temat: Ligji Nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit, Reformat në Deklarimin dhe Pagesën e Tatimeve dhe Kontributeve Pensionale, në mënyrë elektronike, Shembull praktik: si regjistrohet tatimpaguesi në EDI, si bëhet deklarimi dhe pagesa e tatimit përmes EDI-t.

Pjesëmarrës në këto seminare ishin tatimpaguesit e Lojërave të Fatit, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar për temat e lartpërmendura.

Tatimpaguesit e Lojërave të Fatit, u njoftuan me dispozitat ligjore të rregulluara me Ligjin për Lojërat e Fatit, si: mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Lojërave të Fatit, licencimi i subjekteve dhe regjistrimi i punonjësve të Lojërave të Fatit, themelimi i autoritetit të Lojërave të Fatit dhe mbikëqyrja e tyre, ndëshkimet për shkelje të dispozitave ligjore, bashkëpunimin me Policinë e Kosovës, etj.

Gjithashtu, nga zyrtarët e ATK-së, u prezantuan Reformat në Deklarimin dhe Pagesën e Tatimeve dhe Kontributeve Pensionale në mënyrë elektronike, Shembull praktik : si regjistrohet tatimpaguesi në EDI, si bëhet deklarimi dhe pagesa e tatimit përmes EDI-t.

Pjesëmarrësit, fillimisht u njoftuan për procesin në mënyrë të përgjithshme, lidhur me funksionimin e Deklarimit Elektronik (EDI), përparësitë e sistemit, lehtësirat për tatimpaguesit, regjistrimin e tatimpaguesve në EDI, deklarimin dhe pagesat përmes këtij sistemi, etj. Gjithashtu, u prezantuan edhe në detaje shembujt praktik të procesit të Deklarimit Elektronik për TVSh, Tatimit në Paga dhe Kontribute Pensionale.

Për të gjithë tatimpaguesit, të cilët ende nuk janë regjistruar në Sistemin Elektronik EDI, Administrata Tatimore e Kosovës, inkurajoi që të regjistrohen sa më parë dhe të përdorin këtë sistem për deklarim. ATK, që nga tremujori i fundit i vitit 2012 do të ndërpresë mundësinë e shkarkimit të formularëve elektronik për Tatimet dhe Kontributet Pensionale, të cilat do të mundësohen të deklarohen dhe paguhën vetëm përmes Deklarimit Elektronik -EDI.

Gjatë këtij seminari, pjesëmarrësit kanë parashtruar pyetje të ndryshme, lidhur me temat e prezantuara, si dhe pyetje të tjera lidhur me Legjislacionin tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit, ATK iu ka ofruar përgjigjet adekuate.

Pjesëmarrësve u janë shpërndarë materiale informuese, si: Udhëzuesi për Deklarimin Elektronik të Pagave dhe Kontributeve Pensionale, si dhe fletëpalosjet: “Të drejtat dhe obligimet e Tatimpaguesit”, Informata të Përgjithshme për Administratën Tatimore të Kosovës, Pyetje – Përgjigje për TVSh, TAK, TAP, Informata për Borxhin tatimor, Udhëzuesi mbi paraqitjen e Informacioneve mbi Evazionin tatimor, korrupsionin apo sjelljet jo të mira të stafit të ATK-së, si dhe Broshura – Regjistrohu, deklaro dhe paguaj tatimin, si dhe prezantimi i Ligjit të Lojërave të Fatit.

Bashkëpunim ndërinstitucional, për trajtim profesional të tatimpaguesve



Përkushtimi i përbashkët ndërinstitucional, ndihmon shumë në trajtimin sa më të mirë dhe profesional të tatimpaguesve dhe realizimin e misionit të ATK-së, të përcaktuar me ligj. Kështu u tha në takimin e radhës me palët e interesit, organizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi, ishte thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, në interes të tatimpaguesve. Me këtë rast, nga ATK u prezantuan të arriturat dhe sfidat gjatë nëntëmuajorit të këtij viti, si dhe projeksionet për vitin 2013 dhe Plani Paraprak i Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2012/2013.

Pjesëmarrës në këtë takim, ishin përfaqësues nga Ministria e Financave, Auditori i Përgjithshëm, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Trusti Pensional i Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, të cilët u njoftuan për së afërmi me zhvillimet e projekteve dhe reformave që janë realizuar së fundi, për ofrimin e lehtësirave në të bërit biznes.

Gjatë takimit pjesëmarrësit - palët e interesit, kanë shprehur edhe njëherë gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetje të çfarëdo projekti, i cili është në interes të tatimpaguesve. Ata po ashtu, theksuan se ngritja e kapaciteteve vepruese, rritja e shërbimeve kualitative ndaj tatimpaguesve, janë indikatorët kryesor të

cilët u mundësojnë atyre të deklarojnë dhe paguajnë tatimet në mënyrë vullnetare. Ky bashkëpunim do të ndikoj në zvogëlimin e evazionit fiskal, zvogëlimin të hendekut tatimor, si dhe pengimin e pastrimit të parave.

Në anën tjetër, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, z. Behxhet Haliti vlerësoi lartë kontributin e institucioneve, duke theksuar se – “Administrata Tatimore e Kosovës që nga themelimi i saj ka pasur bashkëpunim të frytshëm me institucionet e tjera. Si rezultat i këtij bashkëpunimi janë arritur zhvillime dhe avancime të mëdha në Administratën Tatimore. Të gjitha këto zhvillime, kanë qenë të mundura falë përkrahjes së vazhdueshme të ofruar nga ana juaj, prandaj ne ju falënderojmë të gjithëve që keni dhënë kontribut kaq të madh për progresin tonë”.

z. Haliti gjithashtu nënvizoi se ATK, ka Strategjinë e Përbushjes, në kuadër të së cilës, është Plani i Veprimit për Trajtimin e Rreziqeve për vitin 2012. Duke u bazuar në raportet periodike, shihet se ka pasur progres të konsiderueshëm, në trajtimin e të gjitha rreziqeve në kuadër të këtij plani, si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitucional. Ndër tjera, z. Haliti bëri të ditur se është duke u finalizuar edhe Plani i Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2013, i cili gjatë muajit Nëntor do të finalizohet dhe do të filloj të implementohet nga 1 Janari 2013, për të cilat kërkojë bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Gjatë këtij takimi, para të pranishmëve u prezantuan në mënyrë vizuale reformat e deklarimit elektronik, reformat e regjistrimit të biznesit dhe Plani Paraprak i Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2012/2013.


Rezultatet e E-Deklarimit

Përdorimi i deklarimit elektronik – EDI, i cili i mundëson tatimpaguesve deklarim të shpejt, të thjeshtë dhe të sigurt është duke treguar rezultate mjaft të mira. Ky sistem aktualisht u mundëson tatimpaguesve deklarimin e Tatimit në të Ardhurat Personale, Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar dhe Kontributet Pensionale.

ATK nga tre mujori i fundit i vitit 2012 ka ndërprerë mundësin e shkarkimit të formularëve elektronik për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe Kontributeve Pensionale, nga kjo datë e tutje mundësi e vetme e deklarimit është përmes sistemit elektronike EDI, i cili është në dispozicion 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë.

Ndërsa, sa i përket shkarkimit të deklaratës së Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar, ndërprerja e formës së vjetër të deklarimit është ndërprerë nga 1 Janari i këtij viti. ATK i bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve të cilët ende nuk janë regjistruar në këtë sistem, këtë ta bëjnë sa më parë, sepse kjo do të jetë mënyra e vetëm e deklarimit.

Përmes E-Deklarimit janë regjistruar gjithsej 19,346 tatimpagues, me gjithsej 346,370 deklarata, prej tyre 11,048 t/p për TVSh, 22,442 t/p për Kontribute Pensionale (CM) dhe 22,442 t/p për Tatimin në të Ardhurat Personale.



Grafikoni i E-Deklarimit

Qendra e Thirrjeve: 1 vit punë e suksesshme

Administrata Tatimore e Kosovës, me datën 2 Nëntor të vitit 2011, ka themeluar Qendrën e Thirrjeve, e cila si mision ka njoftimin e tatimpaguesve me obligimet tatimore si: këshilla për mundësitë e pagesës së borxhit, mënyrat e pagesës, si dhe ndihmën që mund t'i ofroj Administrata Tatimore.

Vetëm për një vit, duke zhvilluar aktivitete fillestare, me një numër të vogël të stafit, Qendra e Thirrjeve ka arritur që të kontribuoj në përmbushjen vullnetare të obligimeve të tatimpaguesve, duke reduktuar kohën dhe shpenzimet, që lidhen me udhëtimin për të kontaktuar tatimpaguesit.

Kjo qendër është duke ndihmuar mjaft shumë në reduktimin e mundësive për ndërveprime të pakëndshme, me rreziqe për punëtorët dhe përparime tjera, sipas praktikave pozitive, duke pretenduar kështu të bëhet pika kryesore për kontakt, informim dhe asistencë për tatimpaguesin në të ardhmen.

Për një vit Qendra e Thirrjeve, ka realizuar 14.717 thirrje të suksesshme, nga të cilat janë realizuar 2,184,374.00 euro. Thirrjet telefonike që ka realizuar kjo qendër, nuk kanë qenë të kufizuara vetëm në njoftimin e tatimpaguesve me deklaratat që ju mungojnë në sistem, por edhe për aktivitete të tjera, përfshirë thirrjet për Deklarim Elektronik, arkat fiskale, mos-deklaruesit, si dhe gabime në deklarime.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Qendra e Thirrjeve ka pasur këtë moto “ *Me Qendrën e Thirrjeve informata dhe asistenca për tatimpaguesit është vetëm një telefonat larg* ”.

ATK, do të vazhdoj të bëjë përpjekje në përmbushjen vullnetare të obligimeve tatimore, duke ofruar shërbime profesionale, transparente dhe efektive, në zbatim të drejtë dhe të njëjlojshëm të ligjeve tatimore.



Qendra për regjistrimin e bizneseve One Stop Shop

Në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Doganën e Kosovës, është themeluar Qendra e regjistrimit të bizneseve “One Stop Shop”, e cila ka ndikuar në ngritjen e transparencës, ofrimin e shërbimeve në një vend, integrimin e sistemit të regjistrimit të biznesit, përmirësimin e ambientit biznesor në Kosovë, ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe punësimit, thjeshtësimin dhe lehtësimin e procedurave administrative të regjistrimit të biznesit dhe zvogëlimin e kohës dhe shpenzimeve.

Deri më tani përmes kësaj qendre janë regjistruar 6, 594 biznese të reja.

Bizneset e regjistruara nëpërmjet "One-stop-shop"

Lloji i biznesit	Numri
Ortakëria e përqj.	99
Shoqëri aktiva	18
INDIVIDUAL	5178
SH.P.K.	1815
Totali	6594

Procesi i fiskalizimit

Administrata Tatimore e Kosovës është e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni tatimor dhe plani strategjik i ATK-së. Kontribut të veçantë në ngritjen e mirëqenies për të gjithë qytetarët e Kosovës, kanë të gjithë tatimpaguesit që i kryejnë me obligimet e tyre tatimore konform kërkesave të legjislacionit tatimor, të aplikueshëm në Kosovë.

ATK, në bashkëpunim me operatorët e licencuar për projektin e arkave fiskale, ka vazhduar me shtrirjen e më tutjeshme të projektit të fiskalizimit.

Nga fillimi i muajit Nëntor i vitit 2012, ka filluar instalimi i pajisjeve elektronike fiskale, të veçanta për pikat e shitjes së derivateve të naftës.

Instalimi i pajisjeve elektronike fiskale për pikat e shitjes së derivateve të naftës, në fazën e parë, përfshinë bizneset e NJTM-së, të cilat janë të obliguara të zbatojnë të gjitha kërkesat teknike për instalimin e këtyre pajisjeve fiskale.

Me qëllim të realizimit sa më efikas të projektit të arkave fiskale, ATK ka bërë kategorizimin e bizneseve që posedojnë pika të shitjes së derivateve të naftës dhe bazuar në të do të kërkoj që të pajisen me pajisje elektronike fiskale të veçanta, në mënyrë graduale.

Grupet e bizneseve do të përcaktohen si vijon :

Grupi I: Bizneset që janë në kuadër të NJTM-së,
Grupi II: Bizneset që veprojnë në nivel regional dhe që janë deklarues të TVSh-së,
Grupi III: Bizneset e tjera,

Afatet kohore për realizimin e Projektit të Fiskalizimit

Bazuar në ndarjet grupore të bizneseve siç është cekur më lartë, Administrata Tatimore e Kosovës, ka vendosur që procesi i fiskalizimit të pikave të shitjes së derivateve të naftës të bëhet nëpër faza, duke filluar nga tatimpaguesit e mëdhenj dhe në planin kohor siç është paraqitur më poshtë:

Faza e parë – Grupi I, përfshinë bizneset e NJTM-së.

Afati për t'u pajisur me pajisje elektronike fiskale, më së largu deri më 28/02/ 2013.

Faza e dytë – Grupi II, përfshinë bizneset që veprojnë në nivel regional dhe që janë deklarues të TVSh-së:

Afati për t'u pajisur me pajisje elektronike fiskale, më së largu deri më 31/03/ 2013.

Faza e tretë – Grupi III, përfshinë bizneset e tjera që merren me shitjen e derivateve të naftës dhe nuk i takojnë Grupi I dhe II, të cekura më lartë.

Afati për t'u pajisur me pajisje elektronike fiskale, më së largu deri më 30/04/ 2013.

ATK, është e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni tatimor, andaj të gjithë tatimpaguesit që nuk i përgjigjen kërkesës ligjore për t'u pajisur me pajisje elektronike fiskale, do të ndëshkohen me gjobën prej 1000 euro, bazuar në Ligjin 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kërkesa e përcaktuar me ligj për të regjistruar transaksionet përmes pajisjeve elektronike fiskale (lëshimi i kuponëve me rastin e shitjes së mallrave dhe shërbimeve), do të jetë në dobi të qytetarëve të Kosovës. Kjo përmirëson aftësinë e Administratës Tatimore, për t'u siguruar që të gjithë tatimpaguesit po i përmbushin obligimet e tyre tatimore dhe po i raportojnë me saktësi të ardhurat e tyre.

Për informata të tjera, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit www.atk-ks.org - linku Arkat Fiskale apo kontaktoni zyrat regjionale të ATK-së.

Raportet e institucioneve ndërkombëtare për ATK

I Raporti “Studimi i Fizibilitetit 2012”

1. Ka pasur disa përparime në fushën e ngritjes së kapaciteteve institucionale, kryesisht që lidhet me luftimin e evazionit fiskal.
2. Përmirësimi i reformave tatimore, deklarimi elektronik dhe qendra “One-Stop-Shop”

II Doing Business - Paying Taxes (Kosova 2012)

Radhitja sipas vlerësimit nga 184 vende, **Pagesa e tatimeve 44**

- ✦ Pagesat (*numri i pagesave për vit*) 33
 - ✦ Koha (*orët për vit*) 164 h
- Totali i tatimeve të radhitura (*përqindja e fitimit*) 15.4%

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Klinton & Dëshmorët e Kombit 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 30 & 200 250 07
E-mail: zyra.komunikim@atk-ks.org web: www.atk-ks.org

TELEFONI:

NJTM:	038/200-346-41
NJHT:	038/200-255-52
Prishtina - 1	038/200-255-21
Prishtina - 2	038/200-255-02
Prishtina - 3	038/200-255-17
Pejë:	039/432-812
Gjilan:	0280/326-967
Prizren:	029/244-963
Ferizaj:	0290/321-668
Mitrovicë:	028/590-667
Gjakovë:	0390/330-021